



British Embassy
Pristina



ZËRI I VOTUESVE

Raport për periudhën 16.09.2008 - 31.10.2008

"Zëri i Votuesve"

Raport për periudhën 16.09.2008 – 31.10.2008

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës ka filluar implementimin e projektit "Zëri i Votuesve" më 16.09.2008, në kuadër të cilit është vendosja e kontaktit me qytetarët/votuesit, respektivisht pranimi i ankesave dhe sugjerimeve të qytetarëve për politikanë të caktuar, të nivelit lokal apo qendror dhe mbështetet në tre mekanizma kryesor. Mekanizmi i parë implementues i këtij projekti është linja telefonike e cila ju mundëson qytetarëve thirrje pa pagesë në numrin **0800 201 401**, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në ora 17:00. Mekanizmi i dytë është adresa elektronike zerivotuesve@gmail.com. Ndërsa mekanizmi i tretë implementues i projektit janë takimet me qytetarë, fillimisht të organizuara në 10 komuna të Kosovës. Ky projekt është i përkrahur nga Ambasada Britaneze dhe Post Telekomit të Kosovës (PTK).

Ankesat e pranuar përmes mekanizmit implementues "Linja Telefonike"

Nga data 16.09.2008 dhe deri më 31.10.2008 në linjën "Zëri i Votuesve" janë regjistruar gjithsejt 610 telefonata. Nga numri total i telefonuesve, 457 prej tyre i përkasin gjinisë mashkullore ndërsa 153 prej tyre gjinisë femërore. Telefonatat janë pranuar nga të gjitha regjionet e Kosovës. Përveç komunave të paraqitura në grafën e mëposhtëm, ankesa dhe shqetësime të qytetarëve për pushtetin në nivel lokal apo qendror, ka pasur edhe nga këto komuna: Shterpcë (dy ankesa), Shtime (dy ankesa) dhe Artanë (dy ankesa).

Tabela numër 1. Rangimi i komunave në bazë numrit të thirrjeve të qytetarëve në linjën 'Zëri i Votuesve'

Nr	Komuna	Numri i telefonatave	Nr	Komuna	Numri i telefonatave
1	Prishtinë	84	16	Viti	15
2	Gjakovë	49	17	Kastriot	15
3	Prizren	47	18	Kaçanik	14
4	Të panjohura	46	19	Gjilan	12
5	Drenas	41	20	Lipjan	12
6	Ferizaj	28	21	Vushtrri	12
7	Podujevë	26	22	Deçan	10
8	Klinë	26	23	Istog	9
9	Malishevë	25	24	Fushë Kosovë	5
10	Mitrovicë	24	25	Dardanë	5
11	Suharekë	22	26	Han i Elezit	4
12	Pejë	20	27	Artanë	2
13	Skenderaj	16	28	Shtime	2
14	Rahovec	16	29	Shterpcë	2
15	Dragash	16			

Bazuar në telefonatat e deritanishme nga qytetarët përmes linjës telefonike, ndër ankesat dhe pakënaqësitë kryesore të qytetarëve janë korrupsioni nga liderët e caktuar politikë (në nivel lokal dhe qendror), reduktimet e rrymës, reduktimet e ujit, mungesa e ujësjellësve sidomos në fshatra ku banorët detyrohen të marrin ujë për pije nga pusët të cilat nuk janë të testuara, mungesa e

kanalizimeve në fshatra me ç'rast rrezikohet mirëqenia e qytetarëve si dhe mungesa e rrugëve të asfaltuara në zonat rurale. Papunësia është shqetësim tjetër i qytetarëve, me ç'rast ata theksojnë se si pasojë e kësaj është në rritje migrimi i të rinjve kosovarë.

Nepotizmi është një shqetësim tjetër i ngritur nga qytetarët me ç'rast shumica prej tyre shprehen se përkundër përmbushjes së kriterëve për punësim në ndonjë vend të caktuar pune, ata nuk janë përzgjedhur për shkak të mungesës së lidhjeve familjare me punëdhënësit e caktuar.

Varfëria është një çështje shqetësuese të cilën qytetarët ngritën përmes tre mekanizmave. Pakënaqësi dhe ankesa të shumta janë pranuar edhe lidhur me shërbimet e dobëta shëndetësore dhe mungesën e tyre në fshatra. Mungesa e shkollave, sidomos në zonat rurale është një shqetësim që shumë prindër kanë shfrytëzuar rastin ta shprehin përmes këtij mekanizmi implementues të projektit, duke shtuar se mungesa ekzistuese e shkollave rezulton në vështirësi dhe kualitet të dobët të vijimit të mësimave për shumë nxënës për arsye se në disa vende rurale fëmijët janë të detyruar të ecin deri në katër kilometra për të vijuar mësimin.


Thirrje të shumta janë pranuar edhe nga pensionistët, ankesat e të cilëve lidhen me nivelin e ulët të shërbimeve shtetërore të cilat ata pranojnë, përkundër problemeve shëndetësore të tyre si dhe lidhur me mos aprovimin e ligjit mbi pensionistët.

Menjëherë pas propozimit të Kuvendit të Kosovës lidhur me shtimin e shpenzimeve për deputetë, në linjën 'Zëri i Votuesve' janë paraqitur reagime të qytetarëve, duke shprehur pakënaqësitë e tyre lidhur me këtë propozim.

Një numër i madh i qytetarëve gjithashtu kanë shprehur pakënaqësitë e tyre në lidhje me sistemin gjyqësor në nivel lokal dhe qendror. Ata shprehen se përkundër ekzistimit të ligjit shpesh ndodh që vendimet e gjykatave të mos përkojnë me ligjin e caktuar apo shpesh ndodh që lëndët të neglizhohen nga gjykatësit e caktuar për shkak të favorizimit të lidhjeve familjare.

Nga shumë qytetarë sidomos nga Komuna e Drenasit, Kastriotit dhe Mitrovicës janë ngritur shqetësime në linjën telefonike edhe lidhur me ndotjen e ambientit në këto zona nga KEK-u, Feronikeli dhe vaji sulfurik.

Grafi numër 1. Top dhjetëshi i ankesave të qytetarëve



Përveç ankesave të lartpërmendura, shumë ankesa dhe shqetësime të qytetarëve janë drejtuar edhe në lidhje me mos integrimin e pjesës veriore të Mitrovicës duke e quajtur këtë neglizhencë të autoriteteve lokale, atyre qendrore dhe ndërkombëtare.

Moskujdesi ndaj veteranëve të luftës ishte një shqetësim tjetër i qytetarëve kosovarë, duke pohuar se shumë prej tyre jetojnë në kushte shumë të dobëta shëndetësore dhe ekonomike.

Shqetësim tjetër i qytetarëve që iu vështirëson plotësimin e nevojave elementare duke patur parasysh shkallën e varfërisë dhe papunësisë në Kosovë, janë edhe asistencat e ulëta sociale dhe ndalja e tyre për familjet në të cilat fëmijët mbushin moshën 5 vjeçare.

Përkundër kriterëve të larta nga Ministria e Arsimit për pranim të nxënësve në shkollat e mesme dhe në universitete, shumë qytetarë dhe sidomos nxënës të shkollave të mesme kanë parashtruar ankesat e tyre në lidhje me mungesën e infrastrukturës shkollore duke përfshirë këtu edhe kabinetet për lëndë të ndryshme, mungesa e të cilave iu zvogëlon mundësinë në përmbushjen e kriterëve të parashtruar. Përveç ankesave të lartpërmendura të cilat janë paraqitur edhe në grafin e mësipërm, janë pranuar edhe ankesa në lidhje me:

- moskujdesin e autoriteteve lokale dhe qendrore në lidhje me personat me aftësi të kufizuara duke përfshirë këtu edhe mungesën e shkollave për këtë kategori të popullatës; dhe
- mungesa e fuqizimit të zhvillimit të bujqësisë, pamundësinë e mbjelljes së tokave për shkak të çmimeve të larta të lëndëve përkatëse.

Ankesat e qytetarëve sipas komunave

Siç mund të shihet në grafin numër 1, numri më i madh i telefonatave është pranuar nga qytetarët e ***Komunës së Prishtinës*** me gjithsej 84 telefonata. Brengat dhe ankesat e banorëve të Komunës së Prishtinës, të shprehura përmes linjës 'Zëri i Votuesve' kryesisht lidhen me:

- korrupsionin;
- rrugë të dëmtuara;

- shërbimet e dobëta shëndetësore;
- papunësinë;
- shërbimet e dobëta në sistemin gjyqësor; dhe
- mungesën e ujit në disa lagje të qytetit dhe reduktimi i ujit në përgjithësi.

Përmes linjës telefonike qytetarët kërkonin llogari nga institucionet komunale për donacionin të cilin e dha Qeveria Gjermane për rregullimin e sistemit të ujësjellësit për Prishtinën.

Ndërsa **komuna e Gjakovës** zë vendin e dytë për nga numri i telefonatave me gjithsej 49 telefonata. Ankesat e qytetarëve të komunës së Gjakovës të shprehura në linjën 'Zëri i Votuesve' më së shumti lidhen me:

- numrin e madh të papunësisë në komunë;
- mungesën e shkollave sidomos në zonat rurale;
- mungesën e ujësjellësit në zonat rurale;
- trajtimi i dobët i personave me aftësi të kufizuara; dhe
- funksionimin e dobët të gjykatave dhe me vështirësitë e qytetarëve në pajisjen me dokumentacion për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zyrave që merren me këtë çështje.

Nga **komuna e Prizrenit** janë pranuar gjithsej 47 telefonata të qytetarëve. Ankesat dhe brengat e banorëve të komunës së Prizrenit të shprehura përmes këtyre telefonatave kryesisht lidhen me:

- mungesën e përkujdesjes për invalidët dhe dëshmorëve të luftës;
- mungesën e qendrave sportive;
- mungesën e shkollave për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- mungesën e ambulantave shëndetësore në fshatra;
- kushtet e dobëta për zhvillimin e bujqësisë; dhe
- mungesën e shkollave sidomos në zonat rurale.

Numri i telefonatave të pranuar nga **komuna e Drenasit**, ka arritur në gjithsej 41 telefonata. Ankesat e banorëve të Drenasit të shprehura në linjën 'Zëri i Votuesve' kryesisht kanë të bëjnë me:

- ndotjen e ambientit nga Feronikeli;
- mos ndërtimin e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës;
- mungesën e një zyre në komunë për dërgimin e ankesave;
- nepotizmin; dhe
- mungesën e shenjave të komunikacionit.

Nga **komuna e Ferizajit** deri më tani janë pranuar gjithsej 28 telefonata. Ankesat kanë të bëjnë me:

- moskujdesin institucional ndaj invalidëve të luftës (asistenca të ulëta sociale);
- mosasfaltimin e rrugëve sidomos në zona rurale;
- varfërinë;
- korrupsionin në gjykata; dhe
- mungesa e sigurisë së qytetarëve, sidomos i nxënësve nëpër shkolla.

Numri i telefonatave të pranuar nga banorët e **komunës së Podujevës** deri më tani ka arritur në gjithsej 26 thirrje. Ankesat e banorëve të kësaj komune kryesisht lidhen me:

- dëmtimin e pyjeve;
- nivelin e dobët arsimor në shkolla;
- papunësinë; dhe
- me mungesën e sigurimeve shëndetësore.

Nga **komuna e Klinës** deri më tani janë pranuar gjithsejt 26 telefonata përmes të cilave janë pranuar këto ankesa:

- neglizhenca e komunës ndaj problemeve me të cilat ballafaqohet popullata,
- asistencat e ulëta sociale;
- mungesa e kanalizimeve sidomos në zonat rurale;
- ndërprerja e asistencave sociale dhe rrezikun që ju kanoset fëmijëve të kësaj komune nga kanalizimet e pambyllura; dhe
- mungesa e ujësjellësit në zonat rurale.

Ndërsa nga **komuna e Malishevës** janë pranuar gjithsejt 25 telefonata. Çështjet e ngritura nga banorët e kësaj komune përmes telefonatave lidhen me:

- funksionimin e dobët të sistemit gjyqësor;
- kostoja e lartë për mbjelljen e tokave; dhe
- mungesa e shkollave dhe ujësjellësit në zona rurale.

Janë pranuar 24 telefonata nga **komuna e Mitrovicës**. Ankesat e banorëve të kësaj komune të shprehura përmes telefonatave lidhen me:

- nepotizmin institucional;
- mos asfaltimin e rrugëve sidomos në zona rurale;
- mungesën e ujësjellësve në zona rurale;
- mos rritjen e pagave të punëtorëve teknik të arsimit;
- mungesën e qasjes në spitalin e Mitrovicës për banorët e jugut; dhe
- mos angazhimin e duhur në nivel lokal, qendror dhe ndërkombëtar për integrimin e pjesës veriore të Mitrovicës.

Telefonata janë pranuar edhe nga **komuna e Suharekës** me gjithsejt 22 telefonata. Ndër ankesat më të shpeshta nga banorët e komunës së Suharekës janë ankesat mbi:

- kërkesën e Parlamentit të Kosovës për rritjen e shpenzimeve për deputetë;
- mos rregullimin e çështjes së strehimit për shtëpitë e rrënuara në luftë;
- mungesën e fabrikave dhe çështja e papunësisë; dhe
- mungesa e palestrave sportive.

Nga banorët e **komunës së Pejës** deri më tani në linjën 'Zëri i Votuesve' janë pranuar gjithsejt 20 telefonata. Ankesat e banorëve të kësaj komune kryesisht kanë të bëjnë me:

- mbrojtjen e ambientit;
- me ndërtimet pa leje në këtë komunë;
- sistemin shëndetësor; dhe
- nepotizmin në rastet e pranimit në vende të reja të punës.

Nga **komuna e Skënderajt** në Linjën 'Zëri i Votuesve' deri më tani janë pranuar 16 telefonata. Ankesat e shprehura të banorëve kryesisht lidhen me:

- reduktimet e rrymës;
- vështirësitë e banorëve për pajisje me dokumentacion;
- mos përkujdesjen për familjet e dëshmorëve;
- mospërkrahjen për zhvillimin bujqësor; dhe
- nepotizmin institucional.

Nga **komuna e Rahovecit** deri më tani janë pranuar 16 telefonata. Ndër ankesat kryesore të banorëve të kësaj komune janë:

- mospërkrahja e zhvillimit bujqësor;

- mungesa e pajisjeve kompjuterike në shkolla;
- mungesa e rrymës; dhe
- nepotizmi në shkolla dhe vende të punës.

Numri i telefonatave të pranuar nga **komuna e Dragashit** deri më tani ka arritur në 16 telefonata. Ankesat e banorëve të kësaj komune kryesisht lidhen me:

- mungesën e rrymës;
- mungesën e ngrohjeve qendrore në shkolla;
- mungesën e kontenjerëve për mbeturina; dhe
- mos asfaltimin e rrugëve sidomos në zona rurale.

Edhe banorët e **komunës së Vitisë** kane shprehur shqetësimet e tyre përmes 15 telefonatave të pranuar. Ankesat e banorëve nga kjo komunë kryesisht lidhen me:

- mos funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor;
- ndërtimet pa leje; dhe
- nepotizmin dhe korrupsionin në nivelin lokal.

Nga **komuna e Kastriotit** deri më tani janë pranuar gjithsejt 15 telefonata. Ndër ankesat më të shpeshta të banorëve të kësaj komune janë:

- papunësia;
- mungesa e asfaltimit të rrugëve në zona rurale;
- mungesa e rrymës;
- mungesa e sigurisë; dhe
- mos zgjidhja e çështjes së banimit për banorët të cilëve iu janë shkatërruar shtëpitë gjatë vërshimeve.

Numri i telefonatave të pranuar deri më tani në linjën telefonike nga **komuna e Kaçanikut** ka arritur në 15 thirrje. Ankesat e banorëve të kësaj komune kryesisht kanë të bëjnë me:

- mungesën e shkollave;
- mungesën e zhvillimit ekonomik; dhe
- korrupsionin në nivel lokal.

Deri më tani numri i telefonatave nga banorët e **komunës së Gjilanit** ka arritur në 12. Banorët e kësaj komune ankohen se pushteti i tanishëm nuk ka ndërmarrë asgjë për zhvillimin e komunës përkundër premtimeve të shumta gjatë fushatës elektorale, por edhe për varfërinë dhe papunësinë në komunën e tyre.

Ankesa në linjën telefonike janë pranuar edhe nga **komuna e Lipjanit**. Deri më tani janë regjistruar gjithsejt 12 telefonata nga banorët e kësaj komune të cilat janë:

- nepotizmin në sistemin arsimor;
- mungesa e zhvillimit ekonomik; dhe
- korrupsionin e kryetarit të Kuvendit Komunal lidhur me tregun e Lipjanit.

Numri i ankesave të pranuar nga **komuna e Vushtrrisë** deri më tani ka arritur në gjithsejt 12 telefonata. Ndër ankesat më të shpeshta të banorëve të kësaj komune janë:

- pensionet e ulëta;
- varfëria;
- mungesa e ujit; dhe
- mungesa e rrymës.

Deri më tani janë pranuar 10 telefonata nga banorët e ***komunës së Deçanit*** me rast banorët e kësaj komune kanë shprehur ankesat e tyre të cilat kryesisht lidhen me mungesën e transportit për nxënës të cilët udhëtojnë në fshatra tjera për të vijuar mësimin dhe shume ankesa lidhur me shkatërrimin e pyjeve.

Telefonatat e pranuar deri më tani nga ***komuna e Istogut*** kanë arritur në 9, ku ankesat kryesore janë:

- mungesa e rrymës;
- mungesa e asfaltimit të rrugëve; dhe
- nepotizmi institucional.

Edhe pse në numër të vogël, telefonata janë pranuar edhe nga këto komuna:

Fushë Kosovë me gjithsejt 5 telefonata në të cilat banorët e kësaj komune kanë shprehur ankesat dhe vërejtjet e tyre lidhur më ofrimin e shërbimeve në baza partiake dhe korrupsionin në nivel lokal.

Dardanë, me rast janë regjistruar 5 telefonata të cilat kanë qenë të lidhura me mungesë të ujit, rrymës dhe privilegjimi i pakicës serbe nga ana e qeverisë me rastin e shpërndarjes së mjeteve të punës në bujqësi.

Han i Elezit me gjithsejt 4 telefonata, me rast banorët e kësaj komune kanë shprehur ankesat e tyre në lidhje me: korrupsion në privatizimin e fabrikës së cimentos, mungesën e ujit dhe korrupsionin në Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë.

Artanë me gjithsejt 2 telefonata, shqetësimi i të cilëve ishte mungesa e ujësjellësit në këtë komunë.

Janë pranuar dy telefonata nga komuna e ***Shterpcës*** me rast janë shprehur ankesa në lidhje me mosangazhimin e duhur të Ministrisë së Shëndetësisë në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore si dhe në lidhje me mos angazhim të pushtetit lokal dhe qendror në kthimin e banorëve të kësaj komune në shtëpitë e tyre.

Ankesat e qytetarëve të pranuar përmes Adresës Elektronike

Ankesa dhe shqetësime të qytetarëve janë pranuar edhe përmes adresës elektronike, ku deri më tani janë pranuar 11 letra me gjithsejt 16 ankesa.

Ankesat e qytetarëve të drejtuara përmes adresës elektronike kanë të bëjnë me:

- sektorin energjetik;
- sektorin e shëndetësisë si jofunksional;
- ujin e pijshëm të pamjaftueshëm sidomos gjatë verës;
- sundimin e ligjit i cili është në status quo;
- sovranitetin territorial dhe siguria e vendit;
- stagnimin e politikës së jashtme;
- qeverisjen totalitare;
- kontrollin qeveritar ndaj mediave;
- opozitën pasive në parlament;
- korrupsionin në nivel lokal dhe qendror; dhe
- nepotizmin me rastin e përzgjedhjeve në vendet e punës nëpër ministri dhe administrata institucionale.

Po i paraqesim disa pjesë nga letrat e pranuar ne menyre elektronike:

"Jemi dëshmitarë se në pjesë të ndryshme të Kosovës është duke u bërë asfaltimi i rrugëve. Mirëpo asnjë nga këto rrugë nuk kanë trotuare dhe qytetarët janë të detyruar të ecin rrugës së automjeteve dhe në këtë mënyrë rrezikohet jeta e tyre..."

"Jam një qytetare nga Lipjani. Dua të ju shkruaj dhe të ju tregoj për 'dallaveret' që bëhen në komunën time. Kryetari i komunës posa ka marrë postin, ka marrë mbi vehte në shfrytëzim tregun e lopëve dhe tregun e pemëve. Poashtu edhe ndërtesën e Bankës për Biznes (pronë e Komunës) tani po e shndërron në restorant të vetin..."

"Nëse mendoni se kanë qenë vota të rregullta ato të 2007-ës, e keni huq krejt! Një profesor i imi personalisht e ka pranuar se djali i tij në një vendvotim nga 35 vota sa i ka pasë i ka rritë në 87. Sot ai është këshilltar në një Kuvend Komunal..."

"Kryeministri vazhdimisht thirret në zbatimin e ligjit ndërsa lejon personat që kane bërë keqpërdorime financiare, (si p.sh. ish Kryetari i Kuvendit të Kosovës, ndaj të cilit është ngritur padia penale për keqpërdorim në vendin e punës), të shetisin lirisht rrugëve sikurse s'kanë bërë asgjë. Si juriste, e di që në rast se ndaj një personi ngritet padi penale, ai person duhet të arrestohet me qëllim që gjyqi të konstatoj të vërtetën..."

Ankesat e pranuar përmes takimeve me qytetarë

Ankesa dhe shqetësime të qytetarëve lidhur me pushtetin lokal dhe qendor janë pranuar edhe me rastin e mbajtjes së takimeve me qytetar. Eshte planifikuar te mbahen 10 takime mirepo jane realizuar 8 në këto komuna: Gjakovë, Vushtrri, Kastriot, Viti, Prizren, Drenas, Mitrovicë dhe Fushë Kosovë. Ka dështuar organizimi në Komunën e Gjilanit dhe të Lipjanit.

Takimi i parë me qytetarë u mbajt në **Gjakovë** më 18.09.2008.

Shqetësimet dhe ankesat e ngritura nga qytetarët e komunës së Gjakovës lidhur me pushtetin lokal dhe qendor ishin:

- gjendja ekonomike në komunë;
- për Veriun e Mitrovicës ku ata shprehën se janë jashtë kontrollit të institucioneve të Kosovës;
- mos angazhimi i duhur në njohjen e shtetit Kosovës nga shtetet në botë;
- mërgimi në rritje i të rinjëve të Gjakovës;
- mungesa e zhvillimit të bujqësisë;
- problemet me ujësjellës në fshatrat e komunës;
- ndërtimet e egra në qytet;
- gropat në rrugët e qytetit;
- vështirësitë e pensionistëve për shkak të shumës së ulët të pensionit përkundër problemeve të tyre shëndetësore;
- problemet me shëndetësi sidomos në zonat rurale ku është mungesë e qendrave ambulatore;
- shqetësimet në lidhje me parkun e Gjakovës për të cilin u tha se ekziston rreziku të merret për ndërtimin e një kisha; dhe
- mungesën e shkollave në disa fshatra të Gjakovës me ç'rast fëmijët duhet të vijojnë mësimin në fshatra tjera pavarësisht nga fakti se këto shkolla mund të jenë në largësi deri në 4-5 kilometra.

Ndër qytetarët pjesëmarrës, të pranishëm ishin edhe nxënës të shkollave të mesme të cilët parashtruan ankesat e tyre lidhur me mungesën e sigurisë në shkolla, ushtrimin e dhunës fizike dhe

psiqike (kërcënime) te nxënësit nga ana e mësimeve, mungesën e pajisjeve nëpër shkolla. Pjesëmarrësit nga Hasi i Gjakoves ngritën shqetësime lidhur me kushtet e vështira të jetesës, mungesën e shkollave të mjaftueshme dhe kushtet e dobëta në shkolla.

Takimi i dytë me qytetarë u mbajt në **Vushtrri** më 19.09.2008.

Shqetësimet dhe ankesat e ngritura nga qytetarët e komunës së Vushtrrisë lidhur me pushtetin lokal dhe qendror ishin:

- mundësitë për punësim janë në rënie;
- mungesa e ujit për të cilin qytetarët shprehën shqetësimin e tyre duke pohuar se uji qëndron vetëm 2 orë brenda gjatë 24 orëve ndërsa në disa vende ka mundësi të qëndroj vetëm për 15 minuta gjatë 24 orëve; dhe
- sistemin arsimor.

Takimi i tretë me qytetarë u mbajt në **Kastriot** më 22.09.2008.

Shqetësimet dhe ankesat e ngritura nga qytetarët e komunës së Kastriotit lidhur me pushtetin lokal dhe qendror ndërlidheshin me premtimet e liderëve politik të kësaj komune që sipas tyre pas marrjes së votave kanë kaluar në harresë nga politikanët e zgjedhur. Ankesat dhe shqetësimet tjera të qytetarëve ishin:

- çështja e infrastrukturës së komunës ku ata shprehën se mungon një plan afatgjatë urbanistik dhe zhvillimor i komunës;
- pluhuri të cilin ata thithin çdo ditë si pasojë e termocentraleve;
- rrugët me gropa në të cilat nuk është investuar që nga pas lufta;
- cilësia e dobët në shkolla për shkak të mungesës së shkollave. Për shkak të menaxhimit të dobët nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Kastriot, fëmijët në disa shkolla të kësaj komune ende vijnë në mësimin në kontenjerë në mungesë të hapësirave të mjaftueshme në shkolla;
- mungesa e bashkëpunimit të mirëfilltë mes KEK-ut dhe Kuvendit Komunal gjë që ka ndikuar që KEK-u të mos paguaj taksat për komunën edhe pse është i obliguar me ligj gjë që ndikon në progresin e komunës;
- mungesa e rrymës elektrike me ç'rast ata shprehën pakënaqësitë e tyre duke shtuar se banorët e Kastriotit jetojnë mes dy termocentraleve megjithatë reduktimet e rrymës për këta banorë vlejné sikur se për banorët e tjerë të Kosovës;
- mungesa e aktiviteteve rinore; dhe
- papunësia e cila i detyron të rinjtë e kësaj komune të kontribuojnë në qytete tjera ku ju jepet atyre mundësia.

Nga të pranishmit kishte edhe qytetarë që kishin ardhur të shprehin brengat e tyre individuale në lidhje me dëmtimin e shtëpive nga vërshimet në të cilat ende ka banorë edhe pse jeta e tyre është e rrezikuar, jetojnë atje pa u përfilluar nga komuna.

Takimi i katërt me qytetarë u mbajt në **Viti** më 25.09.2008. Shqetësimet dhe ankesat e ngritura nga qytetarët e komunës së Vitisë lidhur me pushtetin lokal. Te pranishëm ishin edhe nxënësit e shkollës së mesme "Kuvendi i Lezhës" të cilët shprehën pakënaqësitë e tyre lidhur me politizimin e shkollave.

Ndër shqetësimet tjera të qytetarëve ishin edhe:

- mungesa e aplikimit të ligjit për barazi gjinore nga institucionet;
- papunësia në rritje që njëkohësisht rrit numrin e të rinjëve vitias në migrim;
- kostoja e lartë në krahasim me gjendjen aktuale ekonomike në vend, gjë që ndikon në mosplotësim të nevojave elementare të qytetarëve;
- korrupsioni (sipas qytetarëve të Vitisë duhet të ekzistojë një komision special për identifikimin e burimeve nga të cilat pasurohen njerëzit dhe të kontrollohen bizneset në lidhje me pagimin e taksave dhe tatimeve; dhe
- punësimi në arsim mbi baza partiake.

Takimi i pestë me qytetarë u mbajt në **Prizren** më 07.10.2008. Ankesat dhe shqetësimet e shprehura nga qytetarët në këtë takim lidhen me:

- cilësinë e dobët të trajtimit mjekësor si pasojë e të cilit pacientët duhet të transferohen në vende të tjera;
- mungesën e personelit të mjekësisë familjare në viset rurale;
- largimin nga puna mbi baza partiake;
- mungesën e inventarit dhe kushteve të nevojshme në shkolla;
- mungesën e kushteve të nevojshme në infrastrukturë dhe punësim për të hendikepuarit;
- mungesën e transparencës në nivel të qeverisjes lokale dhe qendrore;
- mungesën e rinovimit të konviktit studentor në Prizren;
- mungesën e energjisë elektrike;
- mungesën e kanalizimeve në disa lagje të qytetit;
- mungesën e ndriçimit të rrugëve;
- mungesën e femrave në udhëheqësinë komunale; dhe
- dëmtimin e Drinit të Bardhë dhe mos intervenimin komunal mbi këtë çështje.

Takimi i gjashtë me qytetarë u mbajt në **Drenas** më 09.10.2008

Pas prezantimit të projektit, takimin e përshëndeti Kryetari i Kuvendit Komunal, duke shprehur si dobësi të qeverisë mos pyetjen e qytetarëve se ku dhe çka duhet të punohet. Pasi kryetari dhe zyrtarët e tjerë të KK liruan sallën duke u arsyetuar se qytetarët do të ndihen më të lirë në shprehjen e ankesave të tyre, filluan ankesat e qytetarëve me shqetësimin e tyre në lidhje me ndotjen e ambientit nga Feronikeli duke shprehur se ata kanë të drejtë të jenë në dijeni të pasojave që ju shkakton prezenca e Feronikelit banorëve të Drenasit. Gjithashtu qytetarët e Drenasit shprehën edhe ankesat e tyre në lidhje me: prezencën e mbeturinave në qytet dhe djegien e tyre nga banorët, ndërtimet pa leje, papunësinë e madhe, përkthimin e emrave të vendbanimeve sipas emrave të mëhershëm në gjuhën serbe, mungesën e shenjave të komunikacionit gjë që sipas qytetarëve të Drenasit rrezikon jetën e fëmijëve të tyre, mungesa e rinovimit të shtëpive të shkatërruara gjatë luftës, mungesën e sheshit të qytetit, pasiguria në shkolla, mungesa e shkollave të mjaftueshme gjë që detyron shumë fëmijë të ndjekin shkolla në largësi të vendbanimeve duke rrezikuar shëndetin e tyre. Ankesa të qytetarëve në këtë takim u ngritën edhe nga familjarët e dëshmorëve duke shprehur brengat e tyre në lidhje me fatin e 173 të zhdukurve gjatë luftës dhe nepotizmin e pushtetarëve në ndarjen e pronave për familjet e dëshmorëve. Ekonomia e ulët e komunës ishte një brengë tjetër e qytetarëve duke përfshirë këtu pagesat e ulëta, shqetësimet e tyre mbi rrezikun e mos mbjelljes së zonave bujqësore për shkak të çmimeve shumë të shtrenjta të naftës, farës dhe plehërosjes duke shtuar rrezikun e mbetjes pa ushqime të fëmijëve të tyre.

Takimi i shtatë me qytetarë u mbajt në **Mitrovicë** më 10.10.2008.

Shqetësimet dhe ankesat e ngritura nga qytetarët e komunës së Mitrovicës lidhur me pushtetin lokal dhe qendror kanë të bëjnë me shitjen e pronave nga ana e banorëve shqiptar në pjesën veriore të Mitrovicës duke shprehur se qeveria duhet të sjellë strategji të cilat kanë për qëllim vendosjen dhe mbajtjen e qytetarëve shqiptar në pjesën veriore. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe anëtarë nga Handikos të cilët shprehën ankesat e tyre në lidhje me mos përmbushjen e kushteve të nevojshme për jetesë për këtë pjesë të popullatës përfshirë këtu mungesën e një qendre rehabilitimi, mungesën e punësimit dhe trajtimit të tyre të mirëfilltë nga zyrtarët qeveritar. Shqetësime dhe ankesa të tjera të qytetarëve ishin:

- papunësia;
- punësimi mbi baza nepotizmi;
- privilegjimi i qytetarëve të minoritetit serb nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore duke u lejuar edhe shkeljen e ligjit;

- korrupsioni i inspektorëve gjë që sipas qytetarëve ndikon në ndërtimet pa leje;
- mungesa e infrastrukturës shkollore deri në atë masë sa që mësimdhënësit detyrohen të mbajnë mësim me dy paralele në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën klasë, orët e shkurtëra mësimore deri në 35 minuta dhe numri i madh i nxënësve deri në 50 nxënës në një klasë në mungesë të hapësirës shkollore;
- mungesa e shkollave shqipe në veri;
- mos respektimi i protestës së qytetarëve lidhur me heqjen e administratorit të UNMIK-ut në Mitrovicë;
- mostrajtim i duhur i pensionistëve dhe invalidëve të luftës; dhe
- numri i kufizuar i pranimit të studentëve në Universitetin Shtetëror dhe mungesa e licensimit të univerziteteve private dhe mungesa e kontributit të mjaftueshëm të deputetëve në kuvend.

Qytetarët pjesmarrës në takim shprehën edhe **sugjerimet** e tyre për pushtetin lokal dhe qendror ku kërkuan që të punohet në këto lëmi:

- **Kthimi dhe mbajtja e qytetarëve në pjesën veriore qoftë përmes ofrimit të kredive me taksë të ulëta apo mundësi punësimi;**
- **Respektimi i ligjit edhe për qytetarët serb;**
- **Ndërtim i shkollave në viset rurale; dhe**
- **Rritja e numrit të studentëve në Universitetet Shtetërore.**

Takimi i tetë me qytetarë u mbajt në **Fushë Kosovë** më 16.10.2008.

Shqetësimet dhe ankesat e ngritura nga qytetarët e komunës së Fushë Kosovës filluan me banorët e lagjes së Mirenajve të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të familjeve të 16 dëshmorëve të luftës. Ankesa kryesore e banorëve të lagjes Mirena ishte rruga e pa rregulluar nga e cila sipas tyre rrezikohen fëmijët e tyre gjatë udhëtimit për në shkollë. Ndër të tjera gratë e lagjes Mirena shprehën **"ose të shtrohet rruga në të cilën kalojnë fëmijët tonë për të vijuar mësimin ose në 12 nënat e veja me 37 fëmijë do të dalim në rrugë deri sa kjo të rregullohet"**. Ankesë tjetër e banorëve të kësaj lagjeje ishte edhe papunësia e lartë që mbretëron në këto familje në të cilat jetojnë 12 gra të veja me 37 fëmijë, gjë që sipas tyre lidhet me nepotizmin në punësim dhe neglizhencën e këtyre familjeve nga autoritetet komunale. Gjithashtu shprehën edhe shqetësimin e tyre lidhur me mungesën e ndriçimit të rrugës, kanalizimet e hapura që rrisin rrezikun që iu kanoset fëmijëve të tyre gjatë vijimit të shkollës sidomos për ata fëmijë që përfundojnë orarin mësimor në ora 19:00 pasdite. Shqetësim tjetër ishte edhe largimi i ambulants shëndetësor nga qendra e qytetit dhe dërgimi i saj në Bresje gjë që sipas tyre kjo u vështirëson atyre qasjen në shëndetësi.